

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLIA		
Dalesë / Izlaze: Date / Dana: 04.05.2026		
Nr. Orgv Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 50	Nr. Faqeve. Br. Strana. 2
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO  
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS  
 SKUPSTINA OPŠTINE  
 MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.50  
 Date:30.04.2026

Në bazë të nenit 12 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 4,5,6,7 si dhe neni 8 pika 1.2 dhe neni 14 pika 1 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 4,5 pika 1.3,13 dhe 14 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 51 i Statutit të Komunës së Ferizajt 01 Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2026 miratoi këtë:

#### VENDIM

#### PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PJESËS SË NGASTRËS KADASTRAKE 1510-0, DHE 1511-0 Z.K. RAHOVICË

##### I

Pronat e paluajtshme të cilat propozohen për dhënie në shfrytëzim afatgjatë, janë pjesët e ngastrave kadastrale:

- 1510-0 Z.K. Rahovicë, me sipërfaqe prej 24662 m<sup>2</sup>, pronë e Komunës së Ferizajt,
- 1511-0 Z.K. Rahovicë, me sipërfaqe prej 2763 m<sup>2</sup>, pronë e Komunës së Ferizajt

##### II

Afati për dhënie në shfrytëzim të pjesës së ngastrës kadastrale të cekura në nenin 1 të këtij Vendimi është afatgjatë prej pesëdhjetë (50) vite.

##### III

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të ngastrave kadastrale të cekura në nenin 1 të këtij vendimi është zhvillimi ekonomik.

##### IV

Procesi me të cilin do të bëhet dhënia e pronës së Komunës në shfrytëzim afatgjatë është përmes shprehjes së interesit.

## V

Kriteret e konkursit publik për shprehje të interes për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale janë përcaktuar saktësisht në nenin 20 të Rregullorës (qrk) Nr.09/2020 për përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe ato janë:

- Oferta ekonomikisht më e favorshme që përfshinë,
- Vlera e investimit,
- Numri i të punësuarve nga investimi,
- Lloki i investimit që është me interes publik me prioritet për Komunën,
- Përfitimi financiar dhe ekonomik i komunës,
- Kriteret e tjera të cilat mund të përcaktohen me konkurs.

## VI

Veprimtaria është përcaktuar në destinimin e parcelave ku të njëjtat janë të destinuara për bujqësi.

## VII

Parcelat e përshkruara më lartë janë publikuar në listën e pronave për dhënie në shfrytëzim për Vitin 2026.

## VIII

Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari dhe Kuvendi i Komunës dhe Drejtoria e Pronës Gjeodezisë dhe Kadastrit.

## IX

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.



**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Lokale / Izlazne / Date / Dana: 04.10.51.2026		
Nr. Orgv Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 51	Nr. Faqeve. Br. Strana. 2
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO  
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

**KUVENDI I KOMUNËS  
 SKUPSTINA OPŠTINE  
 MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.51  
 Date: 30.04.2026**

Në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040 pëe Vetëqeverisje Lokale, neni 4, neni 18, të Ligjit Nr.06/L-92 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e Pronës së paluajtshme të Kosovës, neni 18 i Rregullores (QRK) NR.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenin 51 paragrafi 2 pika 2.9 i Statutit të Komunës së Ferizajt 01 Nr.50, të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2026 miratoi këtë:

**VENDIM  
 PËR CAKTIMIN E DY ANËTARËVE TË KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E  
 ANKESAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË NGASTRAVE  
 KADASTRALE 1510-0 DHE 1511-0 Z.K.RAHOVICË**

**I**

Me këtë vendim caktohen dy anëtarë nga kuvendi, dy anëtar i cakton Kryetari i Komunës nga ekzekutivi dhe një shoqëria civile të komisionit për shqyrtimin e ankesave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës,

1. Maliq Muharremi – PDK – Kuvendi i Komunës
2. Arbnor Murseli – VV – Kuvendi i Komunës
3. Arbër Bytyqi – Drejtor në Komunë
4. Alberton Sahiti – Drejtor në Komunë
5. Lorik Krasniqi – Nga shoqëria civile.

**II**

Komisioni i përmendur në pikën një të këtij vendimi formohet nga Kryetari i Komunës në përbërje prej pesë anëtarëve, prej të cilëve, dy anëtar i cakton Kryetari i Komunës nga ekzekutivi i komunës, një antarë caktohet nga sektori joqeveritar lokal dhe dy anëtarët e përmendur më lartë janë pjesë përbërëse e këtij komisioni të caktuar nga Kuvendi i Komunës.

**III**

Mandati i komisionit është dy vjeçar, Brenda mandatit të Kuvendit të Komunës, Komisioni i sipërhënuar do të ketë detyrë që të shqyrtoj të gjitha ankesat lidhur me çështjet për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të ngastrave kadastrale 1510-0 dhe 1511-0 Z.K.Rahovicë.

#### IV

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, dhe Kuvendi i Komunës Ferizaj.

#### V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**  
  
**Xhavit Zariqi**



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLIA		
Dikthe: Izlaze: Date / Dana: <b>04.05.2026</b>		
Nr. Orgv. Org. jed: <b>01</b>	Nr. Prot. Br. Prot.: <b>52</b>	Nr. Faqev. Br. Strana: <b>2</b>
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO  
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

**KUVENDI I KOMUNËS  
 SKUPSTINA OPŠTINE  
 MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.52  
 Date:30.04.2026**

Në bazë të dispozitave nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 te dates 28.06.2013, nenit 24. Parag.4 i Ligjit Nr.06/L-092 Për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, paragrafi 5 i nenit 29 të Rregullores (QRK) nr. 09 /2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2026 miratoi këtë:

## VENDIM

**PËR SHPALLJEN INTERES I PËRGJITHSHËM-PUBLIK TË NGASTRES  
 KADATSRALE: 81-0 Z.K.SAZLI, PRONË PRIVATE, ME QËLLIM TË KËMBIMIT ME  
 PJESËN E NGASTRËS KADASTRALE 753-0 Z.K.SAZLI, PRONË E KOMUNËS SË  
 FERIZAJT.**

### I

Shpallen interes i përgjithshëm publik pjesa e ngastrës kadastrale:  
 - 81-0 Z.K. Sazli, me sipërfaqe prej 310 m<sup>2</sup>, pronë e Mustafë (Adem) Reçica.

### II

Ngastrat kadastrale Shpallet Interes i Përgjithshëm-Publik me qëllim të këmbimit me pjesen e ngastrës kadastrale 753-0 Z.K. Sazli me sipërfaqe prej 310 m<sup>2</sup> pronë e Komunës së Ferizajt në këto parcela është implementuar projekti i rrugës i cili shërben për nevojat e mbarë komunitetit.

### III

Pronat të cilat do të këmben janë të regjistruara parcela 753-0 Z.K. Sazli është në pronësi të Komunës së Ferizajt, parcela kadastrale 81-0 Z.K. Sazli është e regjistruara në emër të Mustafë (Adem) Reçica.

### IV

Obligohet Kryetari i Komunës – Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë që të kërkoj vlerësim të njëjësive kadastrale të përshkruara më lartë nga Ministria e Financave – Departamenti i Tatimit në Pronë, dhe pas vlerësimit të njëjësive të sjell në Kuvend të Komunës Propozimin për Këmbim të këtyre njëjësive.

**V**

Ky vendim nuk ka titull ekzekutiv dhe i njëjti shërben vetëm për vlerësimin e paluejtshmërive.

**VI**

Për zbatimin e këtij Vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës-Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

**VII**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.



**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO  
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLI:

Dalase / Izlaze: Date / Dana: 04/05/2026

Nr. Orgj. Org. jed.	Nr. Prot. Br. Prot.	Nr. Faqev. Br. Strana.
01	53	2

Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO  
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS  
 SKUPSTINA OPŠTINE  
 MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.53  
 Date:30.04.2026

Në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 4, neni 17 të Ligjit Nr.06/L-92 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e Pronës së paluajtshme të Komunës, neni 17 i Rregullores (QRK) NR.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenin 51 paragrafi 2 pika 2.9 i Statutit të Komunës së Ferizajt 01 Nr.50, të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2026 miratoi këtë:

**VENDIM**  
**PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM**  
**AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS, TË NGASTRËS**  
**KADASTRALE 1510-0 DHE 1511-0 Z.K.RAHOVICË**

**I**

Formohet komisioni për vlerësimin e ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim, e cila pronë me Vendimin 01.Nr.50 të datës 30.04.2026 të Kuvendit të Komunës është vendosur të ipët në shfrytëzim afatëgjatë pjesa e ngastrës kadastrale **1510-0 dhe 1511-0 Z.K. Rahovicë**.

Komisioni konform legjislacionit në fuqi duhet të përbëhet prej 5 anëtarëve, ku 2 nga ta duhet të jenë nga Kuvendi i Komunës, 2 të tjerë i propozon Kryetari nga Ekzekutivi si dhe një ka sektori jo qeveritar lokal, si rrjedhoj komisioni ka këtë përbërje:

1. Sadat Ismajli – PDK – Kuvendi i Komunës;
2. Amir Rexhepi – VV – Kuvendi i Komunës;
3. Festina Sadiku Hyseni – Drejtore në Komunë;
4. Balton Dërguti – Drejtor në Komunë;
5. Kenan Gashi – Nga shoqëria Civile.

## II

Komisioni i sipërshënuar ka detyrë që të bëjë vlerësimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së komunës lidhur me pjesën e ngastrës kadastrale **1510-0 dhe 1511-0 Z.K. Rahovicë.**

## III

Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit dhe Kuvendi i Komunës.

## IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.



**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dales / Izlaze: Date / Dana: 04 / 05 / 2026		
Nr. Orgj Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 54	Nr. Faqev. Br. Strana. 2
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO  
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS  
 SKUPSTINA OPŠTINE  
 MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.54  
 Date:30.04.2026

Në bazë të dispozitave nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 te datës 28.06.2013, paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, paragrafi 5 i nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09 /2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2026 miratoi këtë:

## VENDIM

**PËR SHPALLJEN INTERES I PËRGJITHSHËM-PUBLIK TË PJESËS SË NGASTRËS KADASTRALE:63-5 DHE 63-6 Z.K.GËRLICË, PRONË PRIVATE, ME QËLLIM TË KËMBIMIT ME NGASTRËN KADASTRALE 195-0 Z.K.VAROSH, PRONË E KOMUNËS SË FERIZAJT.**

### I

Ngastrat kadastrale të cilat shpallen interes i përgjithshëm janë:  
 - 63-5 Z.K. Gërlicë, me sipërfaqe prej 110 m<sup>2</sup>, pronë e Njazi (Nuhi) Halimi ½ dhe Mustafa (Sylejman) Kurtaliqui ½.  
 - 63-6 Z.K. Gërlicë, me sipërfaqe prej 73 m<sup>2</sup>, pronë e Njazi (Nuhi) Halimi ½ dhe Mustafa (Sylejman) Kurtaliqui ½.

### II

Ngastrat kadastrale Shpallet Interes i Përgjithshëm - Publik me qëllim të këmbimit me ngastrën kadastrale 195-0 Z.K. Varosh me sipërfaqe prej 371 m<sup>2</sup> prone e Komunës së Ferizajt me këto parcela implementohet projekti i rrugës Varosh - Gërlicë që lidhet me magjistralen Ferizaj – Kaçanik.

### III

Pronat të cilat do të këmben janë të regjistruara parcela 195-0 Z.K. Varosh në pronësi të Komunës së Ferizajt, parcelat kadastrale 63-5 dhe 63-6 Z.K. Gërlicë janë të regjistruara në emër të Njazi Halimi ½ dhe Mustafë Kurtaliqui ½.

#### IV

Obligohet Kryetari i Komunës – Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë që të kërkoj vlerësim të njësive kadastrale të përshkuara më lartë nga Ministria e Financave – Departamenti i Tatimit në Pronë, dhe pas vlerësimit të njësive të sjell në Kuvend të Komunës Propozimin për Këmbim të këtyre njësive.

#### V

Ky vendim nuk ka titull ekzekutiv dhe i njëjti shërben vetëm për vlerësimin e paluejtshmërive.

#### VI

Për zbatimin e këtij Vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës - Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

#### VII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



  
Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT - UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA

Dalese / Izlazne: Date / Dana: 07.05.2026

Nr. Orgv. 01. Nr. Prot. 55. Nr. Faqeve. 1.  
Org. p.d. Br. Strana. 1.

Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS  
SKUPSTINA OPŠTINE  
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.55  
Date:30.04.2026

Në bazë të dispozitave të nenit 12 pika 12.1 dhe 12.2 shkronja “d”, nenit 58 shkronja “h” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 7 pika 1.2 të UA (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, neni 25 paragrafi 2, pika 2.1 neni 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës Ferizaj të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2026 miratoi këtë:

**VENDIM  
PËR VËNIE NË KONSULTIM PUBLIK TË RREGULLORES PËR TAKSA  
KOMUNALE**

**I**

Vëhet në konsultim publik Rregullorja për Taksa Komunale

**II**

Diskutimi publik sipas nenit 1 zgjatë 30 ditë

**III**

Propozimet, sygjerimet apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e konsultimit publik.

**IV**

Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria e Financave si dhe ajo e shërbimeve pubike si dhe Zyra Komunale për Informim.

**V**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

  
Xhavit Zariqi

